

**KONTRATË THEMELIMI**  
**E**  
**SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Benaks Konstruksion” Sh.p.k**

Në Pogradec, sot më 10 Mars 2023, në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007”Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve” QKB-në ne Ortakët:

**Besnik Rakip IBI me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, i identifikuar me Kartë Identiteti me nr. 036371710 dhe nr. personal G40901077J, me datëlindje 01.09.1964, i lindur në Çërravë, Pogradec dhe banues në Pogradec,**

**Megi Besnik IBI me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, e identifikuar me Kartë Identiteti me nr. 038367407 dhe nr. personal J65506093T, me datëlindje 06.05.1996, e lindur dhe banuese në Pogradec,**

**Jori Besnik IBI me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, i identifikuar me Kartë Identiteti me nr. 033143348 dhe nr. personal J90906081B, me datëlindje 06.09.1999 , i lindur dhe banues në Pogradec,**

me Kontratën e Themelimit të datës 10.03.2023, vendosëm të krijojmë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar **“Benaks Konstruksion” Sh.p.k.** Për këtë qëllim hartojmë këtë “Kontratë Themelimi” me këto kushte:

Neni 1

Në kuptimin e kësaj Kontrate Themelimi, ortakët Besnik Rakip IBI, Megi Besnik IBI dhe Jori Besnik IBI, janë themelues të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **“Benaks Konstruksion” Sh.p.k.** me seli në adresën: “Rruga Nacionale Pogradec-Korçë, Km 1, pranë Kryqëzimit Buçimas, krahu djathtas, nr. pasurie 759/110, ZK 3167, Pogradec”. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar emërtohet me emrin “Benaks Konstruksion” Sh.p.k. bazuar në Legjislacionin Shqiptar në fuqi, rregullon pozitën juridike të ortakëve dhe pozitën juridike e statusin e administratorit të shoqërisë. Me këtë Kontratë Themelimi rregullohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të shoqërisë, të dhenat me rëndësi për pozitën dhe qëllimin juridik të saj, organizimi, aktiviteti financiar, objekti i veprimtarisë të shoqërisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e saj.


Neni 2

Veprimtaria e Shoqërisë, marrëdhëniet e saj me persona të tretë, privatë e shtetërorë, rregullohen ne baze te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, te ligjit 9723 date 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar, QKB-në,) me akte të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme si dhe në bazë të Statutit e të këtij Akti Themelimi të Shoqërisë **“Benaks Konstruksion” Sh.p.k**

Neni 3

Për detyrimet e veta shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“Benaks Konstruksion” Sh.p.k.** përgjigjet me pasuritë e saja.

1





Neni 4

Objekti i veprimtarisë, emërtimi, selia e shoqërisë, shtimi i ortakëve dhe ato çka janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Benaks Konstruksion” Sh.p.k mund të ndryshojnë me vendimin e Asamblesë së ortakëve dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**Benaks Konstruksion**” Sh.p.k do të jetë:


- Prodhim betoni te markave te ndryshme, ndertime civile dhe ekonomike, veshje fasadash, punime karpenterie, mirmbajtje dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane, ndertime rruges, punime dheu, sistemime, taracime terrenesh etj. Punime duralumini dhe tregtimi i tyre. Ne fushen e ndertimit projektimi ndertim, banesa shume kateshe, prodhim materiale ndertimi, ndertime civile industriale, turistike, bujqesore, rruge, kanalizime, ujesjellesa, gazsjellesa, impiante te ndryshme si dhe konstruksione e restaurime ne fushen e ndertimit, sheshe, permiresim terrene e te tjera, germime dherash, punime murature e beton arme. Ndertim rruge, asfaltime, kanalizime, bonifikime, ne fushen e bujqesise etj. Depozitim materiale te ndryshme ndertimi, grumbullim skrapi, depozitim guri gelqeror. Depozitim inertesh te ndryshme per prodhim betony. Tregtim te materialeve te ndertimit dhe lendeve te para brenda dhe jashte vendit. Tregtim te materialeve elektrike te llojeve te ndryshme, tregtim te pjeseve te kembimit per gjenerator dhe automjete. Tregtim te makinerive dhe pajisjeve per ndertim. Tregtim I artikujve industriale me shumice e pakice, import, eksport, pajisjesh hidrosanitare, elektro shtepiake dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati. Prodhime makinerish te ndryshme e pajisjesh industriale dhe bujqesore dhe venien e tyre ne shfrytezim. Transport te mallrave dhe udhetareve urban, nderurban dhe internacional.

Neni 6

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Benaks Konstruksion” Sh.p.k. e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të krijojë filiale, degë e përfaqësi brënda e jashtë vendit në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe të vendeve të tjera ku mund të vendosë filiale ku do të ushtrorë aktivitetin.

Neni 7

Kontrata e Themelimit të Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Benaks Konstruksion” Sh.p.k do të jetë efektive nga dita e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë “Qendrës Kombëtare të Biznesit”, QKB. Nga kjo ditë, shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Benaks Konstruksion” Sh.p.k fiton statusin e Personit Juridik të pavarur, por aktivitetin e saj mund ta ushtrorë pasi të jetë regjistruar në zyrat e Tatim-taksave dhe të jetë liçensuar nga organet kompetente për ushtimin e veprimtarive ku liçensimi i aktivitetit është kërkesë detyruese nga ligjet specifike që rregullojnë aktivitetet.





Neni 8

Kohëzgjatja e aktivitetit të veprimtarisë së Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të kufizuar “**Benaks Konstruksion**” Sh.p.k do të jetë e pa kufizuar.

Neni 9

Kapitali Themeltar i Shoqërisë tregtare “**Benaks Konstruksion**” Sh.p.k është 1.000.000 lek (një milion) lek. (Sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lek). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë tregtare “**Benaks Konstruksion**” Sh.p.k është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

1. Besnik Rakip IBI është zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme në masën 340.000 (treqind e dyzet mijë) lek e cila përbën 34% (tridhjetë e katër përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Megi Besnik IBI është zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme në masën 330.000 (Treqind e tridhjetë mijë) lek e cila përbën 33% (tridhjetë e tre përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Jori Besnik IBI është zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme në masën 330.000 (Treqind e tridhjetë mijë) lek e cila përbën 33% (tridhjetë e tre përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ky kapital në masën 100% do të jetë i derdhur tërësisht në bankë brenda 30 ditëve pas firmosjes së Statutit të Shoqërisë Tregtare “Benaks Konstruksion” Sh.p.k. Kuotat e pjesëmarrjes në kapital janë të ndashme në rast suksedimi për shkak vdekjeje ose tjetërsimi. Në rast bashkëpronësie të një pjesëmarrjeje, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqësues, i mandatuar, nga të gjithë të përfaqësuarit.

Neni 10

Administrator i Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar “**Benaks Konstruksion**” Sh.p.k. do të jetë Z. Jori Besnik IBI me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, i identifikuar me Kartë Identiteti me nr. 033143348 dhe nr. personal J90906081B, me datëlindje 06.09.1999, i lindur dhe banues në Pogradec, për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë riemërimi ose rizgjedhjeje nga “Asambleja e ortakëve” i cili nuk ndalohej nga ligji, nuk ka konflikte interesi dhe nuk është i lidhur në marrëdhënie të tjera në konceptin e personave të lidhur të cilat mund të prekin figurën e tij nga kërkesat e nenit 13 të ligjit “Për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë”. Detyrat konkrete që mund të kryhen prej administratorit janë të autorizuara nga “Asambleja e ortakëve”. Të gjitha detyrat konkretisht janë të përcaktuara në Statutin e kësaj shoqërie tregtare.

Neni 11

Aktet dhe çdo dokument i shoqërisë “**Benaks Konstruksion**” Sh.p.k. hartohen nga Ortakët, nga “Asambleja e Ortakëve”, nga Administratori apo nga organet zbatuese të saj, firmoset prej “Asamblesë së Ortakëve” ose vetëm nga Administratori i shoqërisë sipas procedurave të përcaktuara në legjislacion. Emërtimi i shoqërisë do të shënohet në të gjitha dokumentat duke u ndjekur menjëherë nga inicialet Sh.p.k. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**Benaks Konstruksion**” Sh.p.k. do ketë vulën me logo të veçantë dhe me specimente të veçanta e cila do të përdoret në të gjitha dokumentat e hartuara gjatë gjithë veprimtarisë së saj.



Neni 12

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**Benaks Konstruksion**" Sh.p.k gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë t'i përdorë ato në përputhje me objektin e qëllimin e veprimtarisë së saj dhe legjislacionin në fuqi. Pas miratimit të bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, fitimi neto i përket ortakut të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "Benaks Konstruksion" Sh.p.k në masën e kontributit të tij në kapitalin Themeltar dhe mund të përdoret lirisht prej tij brenda e jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "Benaks Konstruksion" Sh.p.k. mund të krijojë disa fonde. Ajo mund të krijojë: Fondin Themeltar, Fondin Rezervë e Fondin e Shpërblimit. Per zhvillimin e veprimtarisë së vet shoqëria mund të përcaktoje edhe fonde të tjera.

Neni 14

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**Benaks Konstruksion**" Sh.p.k do të çelë llogari në Banka të ndryshme. Ajo do ta mbajë llogarinë dhe do ta deklarojë në Lekun Shqiptar por mund të mbajë llogaritë edhe në EURO, USD e në monedha të tjera të huaja. Në banka shoqëria mund të hapë llogari dhe të veprojë njëkohësisht me Lekun Shqiptar dhe me të gjitha monedhat e huaja në qarkullim. Veprimet bankare do të kryhen nga Administratori i Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "Benaks Konstruksion" Sh.p.k, Z. Jori Besnik IBI me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, i identifikuar me Kartë Identiteti me nr. 033143348 dhe nr. personal J90906081B, me datëlindje 06.09.1999 , i lindur dhe banues në Pogradec. Ai mund të veprojë me llogaritë bankare të shoqërisë personalisht ose edhe mund të autorizojë një person të tretë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 15

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**Benaks Konstruksion**" Sh.p.k mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti. Bilanci vjetor i shoqërisë tregtare "**Benaks Konstruksion**" Sh.p.k. duhet të miratohet nga "Asambleja e Ortakëve" brenda muajit Mars të vitit pasardhës, kurse vendimi për destinacionet e përdorimit të fitimit neto duhet të merret po nga "Asambleja e ortakëve" brenda dates 30 Qershor të vitit pasardhes.

Neni 16

Për nevoja të veprimtarisë së saj Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**Benaks Konstruksion**" Sh.p.k mund të bëjë punësime të punonjësve duke lidhur kontrata sipas legjislacionit në fuqi në secilin vend ku ushtron veprimtarinë e saj bazuar në rregullat konkrete të vendosura në statut.

Neni 17



Ortakët dhe personat që do të punesohen në shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**Benaks Konstruksion**" Sh.p.k. janë të detyruar të ruajnë karakterin e fshehtë të dokumentacionit, informacionit e burimit të tij, njohuritë e pervojën e fituar apo shkëmbyer në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë, si dhe fshehtësinë e gjëndjes financiare të saj. Ata janë të detyruar të ruajnë të fshehtë identitetin e shumave të depozituara, identitetin e burimeve të investimeve, destinacionet e të ardhurave të shoqërisë, e të depozitave të saj si dhe veprimtarinë e shoqërisë nga goditjet direkte dhe indirekte të konkurrencës. Ndaj atyre që shkelin këto rregulla, Asambleja e ortakëve dhe Administratori ka të drejtë të marrë masa ndëshkimore.

#### Neni 18

Kjo shoqëri tregtare merr cilësinë si "Person Juridik" me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë QKB-së. Ky Statuti i shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "Benaks Konstruksion" Sh.p.k nënkupton se kjo shoqëri tregtare është deklaruar e krijuar me regjistrimin e saj në "Regjistrin Tregtar" dhe më pas të dhënat e saj janë të transferuara dhe të deklaruara në "Qëndren Kombëtare të Biznesit QKB". Përfundimisht ajo konsiderohet e krijuar nga dita kur ajo ka fituar statusin e Personit Juridik.

#### Neni 19

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve, si dhe ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë "**Benaks Konstruksion**" Sh.p.k në lidhje me raportet shoqerore ose për intepretimin dhe zbatimin e këtij statuti dhe të vendimeve ligjërish të nxjerra nga "organet e shoqërisë", nga ato të emëruara prej "Asamblesë së ortakëve" dhe nga administratorët, likuidatorët dhe titullarët ose në raportet me ta, për sa janë shtruar për kompromis, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe kur ato nuk gjejnë zgjidhjen e pranuar, secila palë mund ti drejtohet Gjykatës në rrethin në të cilin shoqëria ka Selinë. Kur mirëkuptimi me kompromise nuk arrihet pavarësisht nga negociatat e realizuara midis palëve, atëherë të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis "Shoqërisë tregtare" dhe palëve të tjera do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "**Benaks Konstruksion**" Sh.p.k ka selinë saj ose në gjykatën territoriale ku ka ndodhur ngjarja.

#### ORTAKU THEMELUES

Besnik Rakip IBI

Megi Besnik IBI

Jori besnik IBI